



ANALIZË E SHKURTËR

Nr. 2/14 – Nëntor 2014

PËRMBUSHJA E KËRKESAVE TË BE- SË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Ky projekt është i përkrahur nga: Komisioni Evropian, Zyra Ndërlidhëse në Prishtinë.



Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë ato të KIPRED-it dhe nuk duhet të konsiderohen si pikëpamje të Komisionit Evropian, Zyra Ndërlidhëse në Prishtinë.

Përgatitur nga: Ariana Qosaj-Mustafa

Hulumtimi i mbështetur nga: Violeta Haxholli, Fisnik Bokshi, Njomza Sejdullahu

Të drejtat autoriale © 2014 nga KIPRED. Çdo të drejtë e mban autori. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të ribotohet a të ruhet diku me qëllim ri-shfrytëzimi, të emetohet në kurrfarë forme apo me kurrfarë mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, incizues apo tjetër, pa u dhënë paraprakisht leja me shkrim nga botuesi. Ju lusim që për informata të kontaktoni info@kipred.org or +381 38 227 778.

Publikuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Rruga "Rexhep Mala", Nr 5A
10 000 Prishtina, Kosovë
Telefon dhe fax: +381 38 227 778
www.kipred.org



Syri i Vizionit
Isa Demaj, Nr. 14 30000
Pejë, Kosovë
Telefon +381 (0) 39 423 240
<http://www.syriivizionit.org>

Përmbajtje

I.	Hyrje	4
II.	Kërkesat e BE-së në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar	5
III.	Përpyqjet e Kosovës: Lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar e ngjuar në mes vullnetit politik dhe rezultateve të dobëta.....	6
	a) Përditësimi i Kuadrit Ligjor Kundër-Korrupsion.....	7
	b) Përgjigja nga organet e sundimit të ligjit në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar....	8
	c) Kapacitetet institucionale për luftimin e korrupsionit.....	12
IV.	Përfundime dhe Rekomandime.....	14

I. Hyrje

Kosova mbetet peng e çështjeve të korrupsionit në pritje të hetimeve të mëtejshme, mbërthyer në një ngatërrësë mes vullnetit deklarativ për të luftuar korrupsionin të elitës politike të tanishme dhe rezultateve aktuale në terren. Një mantra e përgjithshme e qeverisë që nga viti 2008, lufta kundër korrupsionit, do të vazhdojë për aq kohë sa hetimet dhe ndjekjet penale të rasteve të profilit të lartë nuk do të përfshijë edhe figura të rëndësishme politike të qeverisë së tanishme.¹

Përveç kësaj, që nga 15 qershori 2014, Misioni për Sundimin e Ligjit - EULEX në Kosovë ka transferuar kompetencat e veta te homologët e tyre vendorë, duke ulur më tej çdo shpresë se rastet e profilit të lartë që implikojnë edhe qeverinë e tanishme të gjykohen. Transferimi i kompetencave ka treguar rezultate të dobëta siç dëshmohet nga numri i ulët i rasteve të korrupsionit të trajtuara nga Task-Forca Kundër Korrupsionit me vetëm pesë raste penale të iniciuara nga prokurorët special në kuadër të këtij organi². Me akuzat për korrupsion ndaj misionit civil më të madh të BE-së - EULEX, ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të tanishëm të EULEX-it, si dhe hetimeve të përbashkëta të EULEX-it dhe autoriteteve gjyqësore të Kosovës, shpresat e Kosovës për luftimin e korrupsionit të profilit të lartë po zvogëlohen edhe më shumë.³

Prania dhe nevoja për të luftuar korrupsionin në Kosovë ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e BE-së. Disa prej rekomandimeve për Kosovën janë kërkesa për shumë vjet tani, dhe institucionet e Kosovës vazhdimisht kanë dështuar në zbatimin e këtyre rekomandimeve. Në vitin 2014, Kosova është vlerësuar sërish nga BE se ka bërë përparim të kufizuar/modest dhe është në një fazë të hershme në luftën kundër korrupsionit⁴. Për më tepër, raporti i dytë i monitorimit të progresit në përmbushjen e kërkesave të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave ka treguar se ka pasur përmirësime në luftën kundër korrupsionit, por ende ka mungesë të rezultateve aktuale në gjykata.

Për më tepër, BE-ja inkurajon bashkëpunimin e institucioneve të Kosovës me sektorin e OJQ-ve në mënyrë që të rrisë komunikimin e qeverisë me qytetarët e saj, si dhe ndarjen e përvojave të ndryshme, duke përfshirë analizën dhe mësimet e nxjerra nga përpjekjet e vazhdueshme nga institucionet e Kosovës në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ky angazhim është treguar edhe nga mbështetja e BE-së për një numër të organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar dhe raportuar për përpjekjet e vazhdueshme të Kosovës në luftën kundër korrupsionit⁵.

¹ Shih raportin e KIPRED: "Hetimi i Korrupsionit të Kosovës: (Mos) Bashkëpunimi mes policisë dhe prokurorisë", prill 2014.

http://www.kipred.org/advCms/documents/85289_Hetimi_Korrupsionit_Kosove_Mos_Bashkepunimi_Policise_Prokurorise_KIPRED.pdf

² Shih Raportin e progresit 2014, fq.16 .

³ Shih "Deklarata e zëdhënësit për akuzat për korrupsion që përfshijnë EULEX në Kosovë", në, <http://eulex-kosovo.eu/en/news/000527.php>, 29 tetor, 2014.

⁴ Shih Raportin e progresit 2014 në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf, fq 16, tetor 2014.

⁵ KIPRED dhe Syri i Vizionit (SiV) është financuar për të zhvilluar një mjet për të monitoruar përpjekjet e institucioneve të Kosovës në fushat e mëposhtme: Demokracia dhe sundimit të ligjit; Luftimi i Pastrimit të Parave; Parandalimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale; Menaxhimi i Kufijve dhe Bashkëpunimi në zbatimin e Ligjit. Në këtë aspekt KIPRED ka zhvilluar një barometër monitorues për të mbuluar zonat e lartpërmendura, nëpërmjet treguesve që pasojnë atë që është ndërmarrë deri tani dhe çfarë mbetet për t'u bërë në formë të rekomandimeve. Barometri publikohet në faqen e internetit të përgatitur dhe menaxhuar nga KIPRED dhe SiV. Për më tepër, mbështetja e BE-së parasheh botimin e tetë analizave të shkurtëra në fushat e përmendura më lart, të zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me akterët kryesorë të Kosovës.

Analiza e mëposhtme është një rezultat i një monitorimi të përbashkët tremujor (korrik-tetor 2014) e KIPRED dhe SiV.⁶ Ky punim ofron një pasqyrë të gjetjeve aktuale në plotësimin e kriterëve të BE-së në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke analizuar kapacitetet e tanishme të strukturave të mandatuara për të luftuar këto fenomene, duke u fokusuar në gjykatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. Punimi poashtu ofron një numër rekomandimesh në përputhje me kërkesat e BE-së për institucionet e Kosovës, të nevojshme për Kosovën që të tregojë gatishmëri për të administruar shtetin bazuar në sundimin e parimeve të së drejtës dhe për të forcuar luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

II. Kërkesat e BE-së në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Raporti i Progresit i BE-së për Kosovën i vitit 2014 si dhe raporti i dytë i monitorimit për përmbushjen e kërkesave të BE-së për liberalizimin e vizave me Kosovën, liston një numër të kërkesave që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve dhe vullnetit politik në zbatimin e politikave për krijimin e përgjigjeve të duhura strukturore, në mënyrë që Kosova të fillojë me ofrimin e rezultateve nga përpjekjet e saj aktuale për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Në fushën e korrupsionit Raporti i Progresit i BE-së për Kosovën 2014, thekson se edhe pse rastet e korrupsionit ka qenë një prioritet nga ana e shërbimeve gjyqësore dhe prokuroriale, të dhënat për dënime ende mungojnë. Korrupsioni është vërejtur si një problem serioz në shumë fusha por prokurimi publik mbetet ende një shqetësim i madh për Kosovën, pasi që shumica e buxhetit publik është shpenzuar në aktivitetet e lidhura me prokurimin publik. Pa angazhim të vërtetë të elitës politike të Kosovës që duhet të përkthejë përpjekjet e tyre në rezultatet aktuale, Kosova mbetet në fazën fillestare në luftën kundër korrupsionit. Institucionet e Kosovës duhet të forcojnë më tej bashkëpunimin e tyre ndër-institucional duke e forcuar gjyqësorin dhe duke e bërë atë të përgjegjshëm dhe llogaridhënës, në mënyrë që të ofrojnë rezultate efektive në luftën kundër këtij fenomeni.

Në lidhje me rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, edhe pse disa grupe të trafikimit me qenie njerëzore janë të shpërbëra dhe hetimet lidhur me drogën kanë treguar rezultate modeste, numri i ulët i dënimeve dhe konfiskimeve të drogës vazhdojnë të pozicionojë Kosovën në një fazë të hershme të luftimit të këtyre krimeve në krahasim me rajonin.⁷ Për më tepër, BE-ja thekson se me hezitimin e agjencive të zbatimit të ligjit, duke përfshirë edhe hezitimin e prokurorisë të iniciojë hetime financiare, ngrirja dhe konfiskimi i aseteve të kërkuara nga ligji, vazhdon të jetë shumë e ulët.⁸

Në përgjithësi, zbatimi i politikave dhe mekanizmave anti-korrupsion nuk kanë arritur të japin rezultate konkrete pasi që nuk ka pasur mbështetje të mjaftueshme politike për të ofruar mbështetje reale si për shembull mbështetje buxhetore, në zbatimin e këtyre politikave. Edhe pse ligjet janë përmirësuar në një farë mase në lidhje me deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publik, rezultatet mbeten të pakta me numrin e ulët të dënimeve dhe sanksioneve të shqiptuara. Mungesa e traditës për të siguruar një qeverisje transparente dhe të përgjegjshme është pasqyruar edhe nga ngurrimi i përgjithshëm i partive politike të Kosovës për të përmbushur detyrimet e tyre ligjore përkritazi me financimin e partive politike. Në përgjithësi, elita politike e Kosovës

⁶ KIPRED dhe SiV kanë kryer një analizë nga mbi 50 intervista gjysmë të strukturuar me palët kyçe, si dhe në shtator të vitit 2014 ka organizuar një tryezë të rrumbullakët në Prishtinë, me 34 pjesëmarrës, për të diskutuar gjetjet dhe rekomandimet me institucionet e Kosovës.

⁷ Raporti i progresit 2014, fq. 2, në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf

⁸ Po aty, fq. 2.

nuk ka arritur të ndalojë depërtimin e krimit organizuar dhe korrupsionit në sistemin politik, juridik dhe ekonomik të Kosovës.⁹

Monitorimi i BE-së në përmbushjen e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e vizave për Kosovën, vëren se në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar, zbatimi i ligjeve dhe politikave mbetet sfidë e madhe. Në lidhje me zbatimin raporti i dytë i monitorimit shkon përtej disa nga rekomandimeve fillestare, për shkak të rezultateve të dobëta të ofruara në praktikë.¹⁰ Raporti vë në dukje se edhe pse është ngritur një mekanizëm për të evidentuar rastet e ndjekura, prioritizimi i dobët i rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, tregon ngurrimin e prokurorisë aktuale dhe gjykatave që të merren me raste të tilla.

Për më tepër, raporti kërkon që institucionet e Kosovës duhet të forcojnë edhe më tej hetimin e bazuar në intelegjencë si dhe aftësitë analitike për të luftuar korrupsionin dhe rastet e krimit të organizuar. BE-ja në fund vëren se edhe pse ka pasur përmirësime në luftën kundër korrupsionit, Kosova duhet të integrojë hetimet financiare në të gjitha hetimet e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe të krijojë një sistem të mirëfilltë për të ndjekur të gjitha rastet e vendimeve të formës së prerë të gjykatës, duke përfshirë korrupsionin dhe rastet e krimit të organizuar me dënimet penale që ekzekutohen dhe pasuritë kriminale që konfiskohen. Zbatimi i ligjeve dhe politikave vazhdon të mbetet një shqetësim i madh për BE-në në rrugën e Kosovës drejt Liberalizimit të Vizave me vendet e BE-së.

Prandaj, BE-ja rekomandon që qeveria e re dhe parlamenti që do të krijohet pas zgjedhjeve qendrore të mbajtura më 8 qershor 2014, të tregojnë vullnet të qartë politik dhe zero tolerancë ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar me rezultate efektive në këto fusha, në mënyrë që Kosova të afrojë veten me kërkesat e BE-së.

III. Përpjekjet e Kosovës: Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar e ngujuar në mes vullnetit politik dhe rezultateve të dobëta

Një numër i ligjeve dhe politikave janë miratuar nga institucionet e Kosovës për t'iu përgjigjur kërkesave të BE-së në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Nga përditësimi dhe përafrimi i kuadrit ligjor anti-korrupsion me Kodin e ri Penal, për rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, deri te shpikja e një numëri mekanizmash për të hetuar dhe luftuar korrupsionin. Krijimi dhe emërimi i mekanizmave të ndryshëm gjithashtu shërbeu si një taktikë për të transferuar buxhetin në drejtime të ndryshme duke rrezikuar realisht zbatimin e ligjeve dhe të politikave ekzistuese. Në mes të këtyre rrethanave strukturat gjyqësore dhe prokuroriale të Kosovës, si dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, kanë qenë të shtyrë vazhdimisht për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Analiza më poshtë ofron një përmbledhje të kuadrit të përditësuar ligjor në fushën e anti-korrupsionit e poashtu ofron një analizë të përpjekjeve të tanishme të prokurorisë së Kosovës dhe gjykatave për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

⁹ Raporti i progresit 2014, fq. 3 në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf

¹⁰ Shih Raportin nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin Evropian, raporti i dytë i progresit nga ana e Kosovës në përmbushjen e kërkesave të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, fq. 7, http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/second_commission_assessment_en.pdf

a) Përditësimi i Kuadrit Ligjor Kundër-Korrupsion

Kosova ka konsoliduar kuadrin e saj ligjor kundër-korrupsion me amendamentet e tre ligjeve të mëdha, përkatësisht Ligjin për Financimin e Partive Politike,¹¹ Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (në tekstin e mëtejme: Ligji për Deklarimin e Pasurisë)¹² dhe Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike.¹³ Njëpërmjet shtrirjes me dispozitat e Kodit Penal¹⁴, këto ligje sigurojnë që veprat e lidhura me korrupsion janë kriminalizuar.

Përveç kësaj, korniza ligjore e Kosovës është përditësuar pas mandatatit të ripërtërirë të misionit të EULEX-it, duke parashikuar se të gjitha institucionet e sundimit të ligjit do të kryesohen nga zyrtarët e Kosovës dhe është i bazuar në politikën e "normalisht jo raste të reja", që do të thotë se EULEX-i do të merret vetëm me rastet e pranuar para datës 15 prill 2014, dhe të marrë parasysh raste të reja vetëm në bazë të kërkesës nga homologët e tij vendorë. Prokurorët e EULEX-it nuk do të ndërmarin hetime të reja, përveç në rrethana të jashtëzakonshme.¹⁵ Këto "rrethana të jashtëzakonshme" mbeten ende për t'u përcaktuar.¹⁶

Ndryshimet e tjera janë bërë edhe në Ligjin për Deklarimin e Pasurisë nga zyrtarët e lartë, duke detajuar detyrimin e zyrtarit raportues. Për shembull, të ardhurat personale në ligjin e vjetër ishin të përcaktuara si "të ardhura vjetore," ndërsa ligji i ri detajon të ardhurat personale si "... të ardhurat për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që rezultojnë në të ardhura personale."¹⁷ Në lidhje me kontrollin e pasurisë së deklaruar, ligji nënkupton për Agjencinë Kundër-Korrupsion të kontrollojë dhe verifikojë deklaratën e pasurisë, por vetëm njëzet përqind çdo vit. Përzgjedhja bëhet nga një short, ndërsa ushtrimi i një verifikimi të plotë nga ana e Agjencisë për zyrtarin mund të bëhet edhe me kërkesë të personave publik të interesuar.¹⁸ Për më tepër, ligji gjithashtu e bën të detyrueshme që zyrtarët e lartë të japin shpjegime të hollësishme në lidhje me burimin e pasurisë së tyre.¹⁹

¹¹ Ligji Nr. 04/L-212 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058, në, <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndryshimin%20e%20ligjit%20per%20financimin%20e%20subj%20politike.pdf>

¹² Ligji Nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-228%20sh.pdf>

¹³ Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-227.pdf>

¹⁴ Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, edhe pse i ndryshuar ende mbetet një projektligj në pritje të funksionalizimit të Kuvendit të ri. Shumica e ndryshimeve janë të natyrës teknike, kryesisht të lidhura me terminologji. Megjithatë, amendimet kanë dhënë disa ndryshime pozitive në krahasim me versionin e mëparshëm të këtij ligji, në mënyrë të veçantë duke deklaruar afate kohore për parandalimin e konfliktit të interesit. I një rëndësie të ngjashme janë edhe ndryshimet në rolin e stafit të Agjencisë Kundër Korrupsionit për të marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit në të gjitha aktivitetet e prokurimit publik dhe të japin rekomandime për drejtuesit e institucioneve, nëse ndonjë rast i konfliktit të interesit është gjetur.

¹⁵ Shih Ligjin Nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në Mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë në, <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-274%20sh.pdf>

¹⁶ Intervistë e KIPRED me zyrtarë të KPK-së, shtator 2014.

¹⁷ Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 3, paragrafi 2, nënparagrafi 1.7.

¹⁸ Po aty, neni 9, paragrafi 3, pika nënparagrafi 7.

¹⁹ Po aty, neni 9, paragrafi 3, nënparagrafi 5.

Një tjetër ligj i ndryshuar brenda kuadrit ligjor kundër-korrupsion është Ligji për Financimin e Partive Politike. Nga miratimi i tij në vitin 2010, ky ligj është ndryshuar dy herë. Megjithatë, siç tregohet edhe nga raporti i progresit i BE-së i vitit 2014, zbatimi i këtij ligji do të mbetet i dobët, derisa kapacitetet njerëzore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës nuk janë forcuar.²⁰ Ligji ka ndryshuar më tej përkufizimin e kontributeve të dhëna për subjektet politike. Amendamentet ndalojnë që donacioni të bëhet direkt për kandidatin, pasi ai duhet të kalojë nëpër një subjekt politik, duke respektuar dispozitat e këtij ligji.²¹ Në mënyrë që të luftojë praktikën korruptive, dhe të rris dhe të forcojë menaxhimin financiar dhe transparencën, ligji i ri thekson se subjektet politike duhet të zhvillojnë mekanizma të kontrollit të brendshëm financiar.²² Ligji i ndryshuar përcakton gjithashtu dispozitat ndëshkimore që përfshijnë rastet kur subjektet politike pranojnë dhe ekzekutojnë donacione në kundërshtim me ligjin, si dhe rastet kur ato nuk mund të provojë origjinën e të ardhurave të pranuar dhe të kryera.²³

Megjithë ndryshimet e paketës së ligjeve në përputhje me kërkesat e BE-së, zbatimi i këtyre ligjeve do të mbetet një problem. Çështja e pasurisë së pashpjegueshme vazhdon të mbizotërojë në deklaratat e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë që në mënyrë të vazhdueshme tregojnë një rritje në pasuri pa justifikuar siç duhet burimet, siç është thënë shpesh se kanë trashëguar nga burime të ndryshme familjare.²⁴ Asnjë verifikim përcjellës i këtyre deklaratave nuk është bërë në përputhje me rrethanat. Më tej, draft ligji aktual për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik pret miratimin e Kuvendit, por duket se nuk do t'i japë fund praktikave të mbajtjes së funksioneve të shumta të mbajtura nga ana e zyrtarëve publikë, që shihet si një rrezik potencial i konfliktit të interesit për gjyqtarë, prokurorë dhe zyrtarë të lartë.²⁵ Për më tepër, implementimi dhe zbatimi i Ligjit për Financimin e Partive Politike mbetet i dobët, me partitë politike që nuk përmbushin detyrimet e tyre sipas këtij ligji,²⁶ ndërsa zyra e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në krye të zbatimit të monitorimit, vazhdon të mos ketë kapacitete dhe burime për të përmbushur përgjegjësitë e tyre ligjore.

b) Përgjigja nga organet e sundimit të ligjit në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar

Në gjysmën e parë të këtij viti prokuroritë e Kosovës kanë rritur përpjekjet e tyre për të trajtuar kërkesat e BE-së për kundër-korrupsion. Kryeprokurori i Shtetit ka udhëzuar prokurorët e tij, duke përcaktuar "korrupsionin e nivelit të lartë" dhe gjithashtu duke bërë caktimin e prokurorëve special në kuadër të Prokurorisë Speciale (ZPSRK), për t'u marrë me rastet e korrupsionit.²⁷ Për më tepër, në nëntor 2013 Kryeprokurori i Shtetit emëroi prokurorët e caktuar si persona kontaktues kundër-korrupsionit në secilën prokurori.²⁸ Udhëzime të ngjashme janë lëshuar nga

²⁰ Shih Raportin nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, raporti i dytë për përparimin nga ana e Kosovës në përmbushjen e kërkesave të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, fq.7 në,

http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/second_commission_assessment_en.pdf

²¹ Shënim Sipër në 11, neni 6, paragrafi 3, nënparagrafi 4.

²² Po aty, neni 9, paragrafi 1.

²³ Po aty. Neni 12, paragrafi 1., neni 21, Dispozitat Ndëshkuese, paragrafi 5.

²⁴ Shiko raportin e KIPRED "Pandëshkueshmëria Në Kosovë: Pasuria e Pajustificueshme" në, http://www.kipred.org/advCms/documents/30386_Investigating_inexplicable_wealth_ALB.pdf dhe deklaratat vjetore të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik në, <http://akk-ks.org/?cid=1,1>

²⁵ Raporti i Progresit për Kosovën, 2014, fq.15.

²⁶ Po aty.

²⁷ Raporti i Progresit për Kosovën 2014, fq.15 në

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf

²⁸ Intervistë e KIPRED me zyrtarë të KPK-së, shtator 2014.

gjykatat nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK).²⁹ Megjithatë, në përgjithësi rezultatet mbeten shumë të kufizuara me më shumë se gjysma e rasteve të hetuara nga agjencitë e zbatimit të ligjit të ndërprera nga prokurorët. Rastet e hetuara përfshijnë hetimet zyrtare nga prokurorët, si dhe të Policisë së Kosovës.

Për shembull, nga gjithsej raste të trajtuara nga prokurorët e Kosovës kundër 556 personave, prokurorët paditën më pak se gjysmën e rasteve d.m.th 248 persona ose 45% nga gjithsej 556 raste. Më shumë se gjysma e rasteve ose u shkarkuan ose u mbyllën nga hetime të mëtejshme me 308 persona ose 55% të rasteve të pushuara. (shih tabelën 1.1) Për më tepër, prokurorët special të ZPSRK-së kanë normën më të ulët të efektivitetit me normën prej 68 raste ose 89% të gjithsej 76 rasteve, janë hedhur poshtë/mbyllur ose ndërprerë nga hetime të mëtejshme. ZPSRK është e ndjekur nga afër nga prokuroria themelore në Mitrovicë me një normë prej 26 ose 76% të gjithsej 34 rasteve dhe prokurorisë themelore në Pejë që ka shkarkuar/mbyllur dhe ndërprerë hetime të mëtejshme për 47 ose 72% të gjithsej 65 rasteve. Ndryshe, prokuroria themelore në Ferizaj lëshoi numrin më të madh të aktakuzave me 24 raste ose 75% të gjithsej 32 rasteve. Prishtina dhe Gjilani kanë pasur një normë aktakuzash prej 58%. (shih tabelën 1.1).

Shumica e kallëzimeve penale u dërguan për ndjekje penale nga Agjencia Kundër-Korrupsion dhe Policia e Kosovës. Numri i kallëzimeve penale të ofruara nga Agjencia Kundër Korrupsionit ka qenë gjithsej 133 kallëzime penale ose 45% nga gjithsej raste kundër 156 personave, ndjekur nga afër nga ana e Policisë së Kosovës që ka paraqitur 102 kallëzime penale ose 35% kundër 234 personave.³⁰

Gjysma e parë e 2014	Numri i përgjithshëm i personave me kallëzime penale të trajtuara nga prokuroria	Kallëzime penale të shkarkuara / mbyllura dhe ndërprerje e hetimit	%	Gjithsej aktakuza	%
	persona				
Prokuroria Speciale	76	68	89%	8	11%
Prokuroria në Prishtinë	109	46	42%	63	58%
Prokuroria në Prizren	151	72	48%	79	52%
Prokuroria në Pejë	65	47	72%	18	28%
Prokuroria në Gjilan	53	22	42%	31	58%
Prokuroria në Mitrovicë	34	26	76%	8	24%
Prokuroria në Ferizaj	32	8	25%	24	75%
Prokuroria në Gjakovë	36	19	53%	17	47%
Gjithsej	556	308	55%	248	45%

Në lidhje me rastet e pranuar në përgjithësi nga prokuroritë dhe të hapura për hetim të mëtejshëm ose aktakuza, shërbimet prokuroriale të Kosovës përfshirë ZPSRK-në për periudhën janar-qershor 2014, ka pasur 753 të rasteve të korrupsionit të trajtuara, ndërsa vetëm 27%, ose 207 raste u hapën. Më shumë se gjysma e rasteve mbeten të pazgjidhura prej 73%, ose 546 raste.³¹ Shumica e rasteve janë procesuar/hapur në Prishtinë me 52%, ose 389 raste. Për më tepër, prokuroria e Prishtinës ishte më pak e efektshme nga të gjitha rajonet me shkallën vetëm 11% ose 43 raste të procesuara/hapura nga gjithsej 389 raste. Një shërbim prokurorial më pak efektivë kanë qenë prokurorët special të ZPSRK-së që ishin në gjendje të hapin vetëm 16% apo 8 raste prej gjithsej 49 rasteve. Prokurorët me nivelin më të lartë të efektivitetit në trajtimin e

²⁹ Intervistë e KIPRED me zyrtarë të KPK-së, shtator 2014.

³⁰ Shih Raportin gjashtë mujor 2014 (janar –qershor) i Mekanizmit Përcjellës Ndër-Institucional për Harmonizimin e Statistikave për Veprat Penale Karakteristike, fq 42 dhe 43, në dispozicion në http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_gjashtemujor_100920143.pdf

³¹ Po aty.

veprave penale të korrupsionit kanë qenë në rajonin e Gjilanit me 20 raste nga gjithsej 27, pasuar nga prokuroria themelore në Prizren që arriti të hapë 69% ose 61 nga 88 raste (shih tabelën 1.2)

Gjysma e parë e 2014	Gjithsej raste të pranuar	Raste të zgjidhura	% e rasteve të zgjidhura nga gjithsej	Raste të pazgjidhura nga gjithsej	% e rasteve të pazgjidhura nga gjithsej të pranuar
Prokuroria Speciale	49	8	16%	41	84%
Prokuroria Themelore në Prishtinë	389	43	11%	346	89%
Prokuroria Themelore në Prizren	88	61	69%	27	31%
Prokuroria Themelore në Pejë	44	20	45%	24	55%
Prokuroria Themelore në Gjilan	27	20	74%	7	26%
Prokuroria Themelore në Mitrovicë	81	20	25%	61	75%
Prokuroria Themelore në Ferizaj	47	20	43%	27	57%
Prokuroria Themelore në Gjakovë	28	15	54%	13	46%
Gjithsej	753	207	27%	546	73%

Gjatë periudhës gjashtë mujore janar-qershor 2014, gjithsej 48 persona morën vendime gjyqësore lidhur me paditë e tyre për korrupsion. Nga ky numër vetëm 34 persona u gjetën fajtorë, ndërsa 5 persona u liruan nga të gjitha akuzat.³² Janë 200 persona ende në pritje për t'u konfirmuar aktakuzat e tyre nga gjykatat.

Kjo tendencë e trajtimit të dobët të procesimit të rasteve do të vazhdojë së pari të rëndojë shërbimet prokuroriale me grumbullim të rasteve, dhe të ndikojë drejtpërsëdrejti në efektivitetin e shërbimeve të prokurorisë të kërkuara në politikat e nxjerra nga Këshilli Prokurorial i Kosovës si Plani i Veprimit për të Rritur Efikasitetin e Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit.³³ Së dyti, siç tregohet nga të dhënat më shumë se gjysma e rasteve (55%), të procesuara nga prokurorët në tërë Kosovën ishin ose të pushuara, ose të pezulluara nga hetimet e mëtejshme. Edhe pse shërbimet prokuroriale kanë pohuar se shpesh rastet nuk janë të evidentuara mirë numri i madh i rasteve të pushuara është shqetësues.³⁴

Kjo dukuri ka qenë e shtyrë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës mbi prokurorët duke i bërë presion prokurorëve për të qenë më efektivë në luftën kundër korrupsionit nga Plani i Veprimit i përmendur më lartë. Plani i Veprimit përcakton një afat kohor për të gjitha rastet e raportuara deri në nëntor 2013 nga agjenci të ndryshme, duke përfshirë raportet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe kallëzimet penale të ngritura nga ana e policisë se këto raste do të duhej të ngritej aktakuza apo duhet pezulluar/pushuar hetimi deri në muajin qershor 2014.³⁵ Mbetet e panjohur nëse, ky afat u vendos për prokurorët kundër kërkesave ligjore të Kodit Penal të Kosovës që aktakuza do të duhej ngritur deri në dy vite pas fillimit të hetimeve.³⁶ Për më tepër, afati i imponuar ka ngritur shqetësime nëse këto aktakuza të mbyllura përfshijnë edhe rastet selektive të përfundimit të rasteve nga ana e prokurorëve të ndikuara politikisht, gjatë periudhës para zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë në qershor të vitit 2014. Për më tepër, siç është raportuar më parë nga KIPRED, numri i personave kundër të cilëve janë ngritur kallëzime penale krahasuar me numrin e lartë të rasteve të pushuara ose të pezulluara tregon se kërkesa e

³² Po aty, fq. 46.

³³ Plani i Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit, hyri në fuqi më 4 nëntor 2013 deri më 30 qershor 2014, në dispozicion në http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1285.2013-Plani_i_Veprimit_per_Rritjen_e_Efikasitetit_te_Sistemit_Prokurorial.pdf

³⁴ Intervista të KIPRED me shërbimet prokuroriale, shtator 2014.

³⁵ Shiko Artikullin 3, paragrafi 1, Artikulli 4, paragrafi 2 dhe Artikulli 8, paragrafi 5 për të prioritetuar rastet dhe afatet e Planit të Veprimit, në: http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1285.2013-Plani_i_Veprimit_per_Rritjen_e_Efikasitetit_te_Sistemit_Prokurorial.pdf

³⁶ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, Artikulli 159. Në dispozicion në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Procedure%20Code.pdf>

afatit ka rritur trajtimin joprofesional të rasteve nga prokurorët duke hapur dyshime të mëtejshme për keqmenaxhim dhe drejtësi selektive.³⁷ Megjithatë, Kuvendi i ardhshëm i Kosovës do të mund të monitorojnë për të siguruar trajtimin cilësorë të këtyre rasteve që janë pezulluar/pushuar nga hetimet deri në qershor 2014 në mënyrë që të shmangen ndërhyrjet e ardhshme politike në ofrimin e drejtësisë.

Në lidhje me rastet e krimit të organizuar, edhe pse disa grupe të trafikimit të qenieve njerëzore janë shpërndarë dhe hetimet lidhur me drogën kanë treguar rezultate të moderuara, numri i ulët i dënimeve dhe konfiskimet e drogës vazhdojnë të pozicionojë Kosovën në një fazë të hershme në krahasim me rajonin me sekuestrim minimal të drogës dhe dënimet e lidhura me trafikimin.³⁸ Për më tepër, agjencitë e zbatimit të ligjit, duke përfshirë prokurorinë e shtetit kanë qenë ngurruese për të filluar hetime financiare, ngrirjen dhe konfiskimin e asetëve të kërkuara nga ligji.

Siç shihet nga të dhënat më poshtë trajtimi i këtyre veprave penale mbetet shumë i ulët (shih tabelën 1.3 dhe 1.4).³⁹ Institucioneve të Kosovës ende duket se u mungojnë statistikatat e rasteve të ngritura nga ana e prokurorëve për të konfiskuar asetet që rrjedhin nga rastet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe duke përfshirë edhe rastet e drogës dhe trafikimit të qenieve njerëzore.⁴⁰ Policia e Kosovës duket të udhëheqë në numrin e rasteve të paraqitura në hetimet e drogës me kallëzime penale tek prokurorët me 260 raste të raportuara kundër 395 personave nga janar-qershor 2014.⁴¹ Prokurorët ishin në gjendje për të hapur/procesuar vetëm 61% të këtyre rasteve, ndërsa gjykatat kanë qenë në gjendje për të dënuar vetëm 33% të rasteve të akuzuara.⁴² Kjo tregon mosefektivitet të gjykatave për të reaguar në kohë ndaj aktakuzave të ngritura si dhe ngre më tutje shqetësim për kapacitetet e gjykatave për të trajtuar këto raste.

Tabela 1.3: Gjendja e kallëzimeve penale të Drogës në bazë të Raportit 6 muhor 2014 të KPK-së					
Gjysma e parë e 2014	Gjithsej raste të pranuar	Raste të zgjidhura	% e rasteve të zgjidhura nga gjithsej	Raste të pazgjidhura nga gjithsej	% e rasteve të pazgjidhura nga gjithsej të pranuar
Prokuroria Speciale	16	1	6%	15	94%
Prokuroria Themelore në Prishtinë	229	35	15%	194	85%
Prokuroria Themelore në Prizren	79	32	41%	47	59%
Prokuroria Themelore në Pejë	53	24	45%	29	55%
Prokuroria Themelore në Gjiilan	33	32	97%	1	3%
Prokuroria Themelore në Mitrovicë	78	17	22%	61	78%
Prokuroria Themelore në Ferizaj	46	18	39%	28	61%
Prokuroria Themelore në Gjakovë	15	2	13%	13	87%
Gjithsej	549	161	29%	388	71%

³⁷ Shiko raportin e KIPRED Seksionin IV. Konkluzionet dhe Rekomandimet në “Hetimi i Korrupsionit në Kosovë: (Mos) Bashkëpunimi në Mes të Policisë dhe Prokurorisë”, prill 2014

http://www.kipred.org/advCms/documents/85289_Hetimi_Korrupsionit_Kosove_Mos_Bashkepunimi_Policise_Prokurorise_KIPRED.pdf

³⁸ Raporti i Progresit për Kosovën 2014, fq. 2 në

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf

³⁹ Po aty, fq.2.

⁴⁰ Komunikim me e-mail i KIPRED me Koordinatorin Kombëtar për luftën kundër Krimeve Ekonomike, Shqipdon Fazliu, 30 tetor, 2014.

⁴¹ Raporti gjashtë muhor 2014 i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

⁴² Po aty.

Tabela 1.4: Gjendja e kallëzimeve penale të TQN në bazë të Raportit 6 muhor 2014 të KPK-së					
Gjysma e parë e 2014	Gjithsej raste të pranuar	Raste të zgjidhura	% e rasteve të zgjidhura nga gjithsej	Raste të pazgjidhura nga gjithsej	% e rasteve të pazgjidhura nga gjithsej të pranuar
Prokuroria Speciale	2		0%	2	100%
Prokuroria Themelore në Prishtinë	24	2	8%	22	92%
Prokuroria Themelore në Prizren	5		0%	5	100%
Prokuroria Themelore në Pejë	3		0%	3	100%
Prokuroria Themelore në Gjilan	2	1	50%	1	50%
Prokuroria Themelore në Mitrovicë	5	2	40%	3	60%
Prokuroria Themelore në Ferizaj	9	1	11%	8	89%
Prokuroria Themelore në Gjakovë	2	2	100%		0%
Gjithsej	52	8	15%	44	85%

Për më tepër, në lidhje me sekuestrimin dhe ngrirjen e aseteve nga krimet e korrupsionit dhe krimet të organizuar, duke përfshirë rastet e drogës dhe trafikimit të qenieve njerëzore, sipas Agjencisë së Kosovës për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AMPSK) shumta e përgjithshme e aseteve të sekuestruar përkohësisht në 2013 ishte rreth 1.5 milion Euro. Megjithatë, këto raste janë në pritje të vendimeve përfundimtare të gjykatave dhe nuk mund të konfiskohen në mënyrë të përhershme dhe të transferohen në buxhetin e Kosovës.

Vlera e të ardhurave nga krimet e korrupsionit, krimet të organizuar duke përfshirë trafikimin e drogës dhe qenieve njerëzore të konfiskuara ishte vetëm 6,700 mijë euro në vitin 2013. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2014 shumta e parave të konfiskuara me vendimet përfundimtare të gjykatës ishte rreth 3,540 mijë Euro.⁴³(shih tabelën 1.5). Këto shifra të ulëta në sasinë e konfiskuar tregojnë ngurrimin e institucioneve të Kosovës për të ecur përpara me kërkesat e BE-së në lidhje me dënimet penale të kryera dhe konfiskimin e aseteve kriminale.

Tabela 1.5 Sekuestrimet e përkohshme dhe konfiskimet e përbërshme

Masat ligjore në lidhje me të ardhurat nga krimi	Viti 2013	Jan-Qersh 2014						
	Gjithsej	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Gjithsej
Sekuestrimet e Përkohshme	1,555,258.43 €	71,411.00 €	65,890.85 €	20,000.00 €	60,229.00 €	36,021.00 €	43,400.00 €	296,951.85 €
Konfiskimet	6,700.00 €	866.45 €	0 €	822.00 €	1701.00 €	141.00 €	0 €	3,530.45 €

Ngurrimi për të filluar hetime financiare, ngrirjen dhe konfiskimin e aseteve të kërkuara nga ligji, kanë treguar se agjencitë për zbatimin e ligjit dhe prokuroritë e shtetit i'u mungon gatishmëria për zbatimin e plotë të legjislacionit si dhe kanë mungesë të kapaciteteve që të merren me raste të tilla. Kjo mungesë e vullnetit ndiqet shpesh nga një taktikë "duart-larg" për të vonuar trajtimin e rasteve të profilit të lartë shpesh të implikuar në krim të organizuar dhe korrupsion, për shkak të pavarësisë së pamjaftueshme institucionale që nuk është garantuar nga elita e tanishme politike e Kosovës.

c) Kapacitetet institucionale për luftimin e korrupsionit

Rezultatet e dobëta të agjencive të zbatimit të ligjit dhe të prokurorisë së shtetit janë përcjellur me kapacitetet e dobëta të gjykatave për t'u marrë me rastet e korrupsionit dhe krimet të organizuar, duke theksuar më tej nevojën e rritjes së kapaciteteve të këtyre organeve të sundimit të ligjit. Një përqindje e konsiderueshme e rasteve të kallëzimeve penale për mbylljen e hetimeve ose ndërprerjen e tyre, e që pasohet me një përqindje të moderuar të aktakuzave, tregon nevojën për të rritur cilësinë e punës hetimore dhe kapacitetet e organeve të mandatuara, për të kryer funksione të tilla. Nevoja e ndërtimit të kapaciteteve është konfirmuar edhe në intervistat që

⁴³ Po aty.

KIPRED ka realizuar me të gjitha palët e interesuara, duke kërkuar mbështetje në fushën e hetimeve cilësore, policimin e udhëhequr në inteligjencë dhe bashkërendimin më të ngushtë të të gjitha organeve të përfshira, në mënyrë të ngritjes së cilësisë dhe efektivitetit të hetimeve.⁴⁴

Në lidhje me rritjen e kapaciteteve në kuadër të organeve të sundimit të ligjit, në përgjithësi, ka pasur rritje të numrit të stafit gjatë vitit 2014 në krahasim me vitet e mëparshme. Në vitin 2014, numri i gjyqtarëve është rritur në 322 gjyqtarë, nga 258 sa ishin në vitin 2013. Gjithashtu, numri i prokurorëve është rritur nga 146 në 171 prokurorë, në krahasim me vitin 2012.⁴⁵ Për më tepër, numri i prokurorëve përgjegjës për trajtimin e rasteve të korrupsionit është rritur nga 13 në 42 prokurorë. Edhe pse ka pasur një rritje të stafit në shërbimet e prokurorisë, numri i tyre është ende i ulët në krahasim me vendet ku në 100.000 banorë, Hungaria ka 17.3 prokurorë, Mali i Zi ka 13.4 dhe Kroacia ka 11.0, ndërsa Kosova ka 9.8 prokurorë. Gjithashtu, si prokuroritë ashtu edhe gjykatat, vazhdojnë të përballen me vështirësi në rekrutimin e stafit nga grupet minoritare, në veçanti nga minoriteti serb, edhe pse ky numër është reflektuar në shifrat e mësipërme të përmendura.⁴⁶

Në mënyrë që të rritet më tej efikasiteti i prokurorëve që kanë të bëjnë me rastet e korrupsionit, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) synon që të specializojë një numër të prokurorëve që merren ekskluzivisht me rastet e korrupsionit. Ata gjithashtu synojnë në plan afatgjatë, që të ketë prokurorë të specializuar sipas llojit të veprës. Kjo do të sigurojë një kuptim më të mirë të rasteve nga prokurorët, si dhe më pas rritjen e profesionalizmit dhe efikasitetit të tyre në trajtimin e rasteve.⁴⁷

Si duket, numri i madh i rasteve të korrupsionit që ende janë në pritje për t'u përpunuar/procesuar, duke përfshirë edhe raste të tjera, nuk duhet të vëzhgohet vetëm si rezultat i performancës së dobët të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Një faktor kontribues për mungesën e ekuilibrit të tillë, është gjithashtu edhe menaxhimi i papërshtatshëm elektronik i çështjeve, si dhe baza e centralizuar e të dhënave për regjistrimin e rasteve penale. Si pasojë e kësaj, një rast i ngjashëm llogaritet disa herë për shkak të kodeve të ndryshme të administratës dhe organeve të sundimit të ligjit.

Për të përmirësuar këtë situatë, Ambasada Norvegjeze në Kosovë është duke mbështetur krijimin e një sistemi të menaxhimit të rasteve bazuar në TIK, gjë që do të ndihmojë në përmirësimin e efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së këtyre organeve për sundimin e ligjit.⁴⁸ Për të lehtësuar këtë bazë të dhënash, disa trajnime janë planifikuar për akterët relevant në kuadër të organeve për sundimin e ligjit, në mënyrë që zbatimi i këtij projekti të rëndësishëm të shkojë pa pengesa.⁴⁹ Siç është raportuar më parë nga KIPRED, institucionet e Kosovës duhet të shqyrtojnë me kujdes dhe të vlerësojnë këto trajnime, pasi që ata nuk mund t'i ofrojnë vetes luksin që të dështojnë në zbatimin e këtij projekti, dhe kjo për shkak të pasojave që një dështim i

⁴⁴ Punëtorja e organizuar nga KIPRED me akterët kryesorë nga gjykatat, prokuroria dhe policia, e mbajtur në Prishtinë, më 15 shtator 2014.

⁴⁵ Komunikim i KIPRED me Ministrinë e Punëve të Brendshme përmes e-mailit, Përmbledhja përfundimtare e Zbatimit të Udhërrëfyesit mbi Liberalizimin e Vizave, gusht 2014

⁴⁶ Intervistat e KIPRED me zyrtarë nga KGJK dhe KPK, shtator 2014.

⁴⁷ Intervistë e KIPRED me zyrtarë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, shtator 2014.

⁴⁸ Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme ka ndarë 6.6 milion euro për një projekt që parashikon një Sistem për Menaxhimin e Rasteve dhe të Informatave të bazuar në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (CMIS), për gjyqësorin dhe prokurorinë e Kosovës. Ambasada Norvegjeze në Prishtinë, Ngjarjet, 16 shtator 2013: "Norvegjia mbështet sistemin e menaxhimit të rasteve dhe të informacionit për gjyqësorin e Kosovës" në, http://www.norway-kosovo.no/News_and_events/Policy/Norway-Supports-Case-Management-and-Information-system-for-the-Kosovo-Judiciary/#.VDU8qVfyQ5Y

⁴⁹ Intervistat e KIPRED me zyrtarët e KGJK-së dhe KPK-së, gusht dhe shtator 2014.

tillë mund t'i shkaktojë administrimit të përgjithshëm të sundimit të ligjit në Kosovë, progresit të saj drejt liberalizimit të vizave dhe procesit të integritimit në BE.⁵⁰

Përveç numrit të pamjaftueshëm të stafit dhe mungesës së një sistemi të duhur të menaxhimit të rasteve, prokuroritë dhe gjykatat gjithashtu vazhdojnë të përballen me kushte të papërshtatshme të punës, kryesisht për shkak të mungesës së infrastrukturës së përshtatshme në ndërtesa të vjetra dhe mungesës së pajisjeve të duhura për punë.⁵¹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës vazhdon të punojë për vite me rradhë në kontejnerë, që shërbejnë si zyra të improvizuara, dhe duket se ky problem nuk do të zgjidhet në të ardhmen e afërt.

IV. Përfundime dhe Rekomandime

Zbatimi i ligjeve dhe politikave mbetet sfidë e madhe për institucionet e Kosovës, e vënë re edhe nga BE-ja në raportin e progresit. Me gjithë ndryshimet e pakos së ligjeve në fushën e kundër korrupsionit në përputhje me kërkesat e BE-së, zbatimi i këtyre ligjeve mbetet problem. Në mënyrë që Kosova të avancojë në procesin e integritimit në BE dhe plotësimin e kërkesave të liberalizimit të vizave, institucionet e Kosovës duhet të lëvizin përtej gatishmërive deklarative për të luftuar korrupsionin dhe të ofrojnë rezultate konkrete në terren.

Më tej, Kosova mbetet e pushtuar nga çështjet e korrupsionit në pritje të hetimeve të mëtejshme. Një mantra e përgjithshme e qeverisë që nga viti 2008, lufta kundër korrupsionit, do të vazhdojë për aq kohë sa hetimet dhe ndjekjet penale të rasteve të profilit të lartë nuk do të përfshijnë edhe figura të rëndësishme politike duke përfshirë ato të qeverisë së tanishme.

Tashmë transferimi i kompetencave nga EULEX-i është duke dhënë rezultate të dobëta, gjë që dëshmohet nga numri i ulët i rasteve të korrupsionit të trajtuara nga prokurorët special të Task-Forcës së PSRK-së mbi korrupsionin, me vetëm pesë raste penale të iniciuara nga ky organ. Me akuzat e tanishme për korrupsion ndaj misionit civil më të madh të BE-së - EULEX, dhe për gjyqtarët dhe prokurorët e tanishëm të EULEX-it, shpresat e Kosovës për luftimin e korrupsionit të profilit të lartë po veniten.

Në përgjithësi, rezultatet mbeten shumë të kufizuara me më shumë se gjysmën e rasteve të hetuara nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe të ndërprera nga prokurorët. Gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2014, prokurorët e Kosovës kanë pushuar/pezulluar nga hetimi një numër të konsiderueshëm të kallëzimeve penale për 55% të rasteve ose kundër 308 personave. Kallëzimet penale kanë përfshirë rastet e hetuara nga ana e prokurorët, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe të Policisë së Kosovës. Më tej, prokurorët special të PSRK-së kanë normën më të ulët të efektivitetit me normë prej 89% të rasteve të pezulluara apo të pushuara nga hetimi i mëtejshëm. Normë pozitive kanë rajoni i Prishtinës dhe ai i Gjilanit me numrin e rasteve të ngritura të aktakuzës për rreth 58% të rasteve.

Në lidhje me konfiskimin e drogës dhe rasteve të trafikimit me qenie njerëzore, Policia e Kosovës kryeson vetëm me numrin e rasteve të hetimeve të drogës, të cilat i që ka paraqitur, me rreth 260 raste të raportuara kundër 395 personave. Megjithatë, shkalla e dënimit ka qenë shumë e ulët nga gjykatat, të cilat kanë qenë në gjendje për të dënuar vetëm 33% të rasteve të ngritura.

⁵⁰ Ambasadori norvegjez në Kosovë, z. Ian Braathu, e ka bërë të qartë për autoritetet e Kosovës që në rast të mungesës së përparimit në fazën aktuale (të parë), qeveria norvegjeze do të rishqyrtojë vazhdimin e mbështetjes së këtij projekti. Shih fq. 9 raportin e KIPRED: "Hetimi i korrupsionit në Kosovë: (mos) Bashkëpunimi në mes të policisë dhe prokurorisë", prill 2014, në

http://www.kipred.org/advCms/documents/85289_Hetimi_Korrupsionit_Kosove_Mos_Bashkepunimi_Policise_Prokurorise_KIPRED.pdf

⁵¹ Intervistë e KIPRED me zyrtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gusht 2014.

Vlera e të ardhurave të konfiskuara për shtetin e Kosovës që rrjedhin nga rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë trafikimin e drogës dhe qenieve njerëzore, ishin vetëm 6,700 mijë euro në vitin 2013. Gjatë vitit 2014, shuma deri tani e konfiskuar me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës ka qenë përafërsisht 3,540 mijë Euro. Të ardhurat e tilla të ulëta të konfiskimit, tregojnë ngurrimin e institucioneve të Kosovës për të ecur përpara në kërkesat e BE-së në lidhje me ekzekutimin e dënimeve penale dhe kthimin e asetëve kriminale. Për më tepër, ngurrimi për të filluar hetime financiare, për të ngrirë dhe konfiskuar asetet sipas kërkesave të ligjit, ka treguar se agjencive të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë së shtetit iu mungon gatishmëria për zbatimin e plotë të legjislacionit, të përcjellur nga mungesa e kapaciteteve që të merren me raste të tilla.

Kjo mungesë e vullnetit ndiqet shpesh nga taktika "duart-larg", për të vonuar trajtimin e rasteve të profilit të lartë, shpesh të implikuara në krim të organizuar dhe korrupsion, për shkak të pavarësisë së pamjaftueshme institucionale dhe mosgarantimit të mbështetjes buxhetore në mënyrë adekuate nga elita e tanishme politike e Kosovës.

KIPRED propozon rekomandimet e mëposhtme për të përmirësuar, në përgjithësi, përmbushjen e kërkesave të BE-së në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar:

- Kuvendi dhe qeveria e ardhshme duhet të rrisin në përgjithësi garancitë ligjore dhe kushtetuese për të siguruar pavarësinë dhe autonominë e prokurorëve me anë të specializimit të përshtatshëm të tyre dhe rritjes së buxhetit për prokurorët, në mënyrë që të hapin vend për prokurorët e Kosovës për të filluar iniciimin e hetimeve pro-aktive, të cilat lidhen edhe me figurat e profilit të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- Në mënyrë që të rritet më tej efikasiteti i prokurorëve që kanë të bëjnë me rastet e korrupsionit, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), gjithashtu duhet të përshpejtojë planet e saj për specializimin e një numri të prokurorëve që merren ekskluzivisht me rastet e korrupsionit. Kjo do të sigurojë një kuptim më të mirë të rasteve nga prokurorët dhe më pas rritjen e profesionalizimit dhe efikasitetit të tyre në trajtimin e rasteve. Për më tepër, KPK-ja duhet të kërkojë nga Kuvendi i ardhshëm, rritjen e numrit të prokurorëve special të PSRKS-së në numër të mjaftueshëm dhe rritjen e përgjithshme të buxhetit të kësaj zyre;
- Përqindja e konsiderueshme e rasteve të kallëzimeve penale të pushuara ose të pezulluara nga hetimi i mëtutjeshëm, tregon nevojën për të rritur cilësinë e punës hetimore dhe kapaciteteve të organeve të mandatuara për të kryer funksione të tilla. Institucionet e Kosovës duhet të ofrojnë rregullisht trajnime të specializuara, duke përfshirë trajnimet në hetimet financiare, konfiskimin dhe kthimin e asetëve tek agjencitë e zbatimit të ligjit, në mënyrë që të rrisin kapacitetet e tyre hetimore;
- Konfiskimi dhe kthimi i asetëve nga krimi i korrupsionit dhe ai i krimit të organizuar, duke përfshirë drogën dhe rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, vazhdon të jetë në nivel të ulët përkundër shumë përpjekjeve të institucioneve të Kosovës për të krijuar një numër shtesë të mekanizmave. Kosova duhet të marrë në konsideratë nevojën për të përmirësuar kornizën ligjore, duke marrë në konsideratë zhvendosjen e barrës së provës tek të dyshuarit në manyrë të përkohshme, në mënyrë që të rritet probabiliteti i zbatimit të ligjeve për konfiskim nga institucionet e sundimit të ligjit;
- Institucionet e EULEX-it dhe të Kosovës duhet të vazhdojnë hetimet e tyre në çështjet e supozuara për korrupsion nga ana e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të tyre. Për më

teper, trajtimi i pershtatshem i hetimit duhet te jete transparent, i menjehershem dhe te siguroje pergjegjshmerine ndaj taksapaguesve te BE-se dhe qytetarëve te Kosovës, duke raportuar rezultatet e hetimit ne Kuvendin e ardhshem te Kosovës. Kjo menyre e procedimit do te ofrojë mundësi per misionin e EULEX-it, per te ofruar ne perputhje me mandatin e misionit te vet dhe pergjegjshmerine e tij qe shpesh predikohet ndaj institucioneve te Kosovës;

- Institucionet e Kosovës duhet te shqyrtojne me kujdes dhe te vleresojne nevojat e ndertimit te kapaciteteve, si dhe trajnimet per sistemin e menaxhimit te rasteve bazuar ne TIK, pasi qe ata nuk kane luksin te deshtojne ne zbatimin e ketij projekti, per shkak te pasojave qe nje deshtim i tille mund t'i shkaktojë administrimit te pergjithshem te sundimit te ligjit ne Kosove dhe progresit te saj drejt liberalizimit te vizave dhe procesit te integritimit ne BE.